

VENDIM

Nr.798, datë 3.3.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në bazë të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendosa delegimin e çdo kompetence që më jep ligji nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokuro-rëve në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktuara në nenet 8, pika 6; 9, pikat 4 dhe 5; dhe 10, pika 10 të tij, zotit Alban Brati, drejtor i Shërbimit Juridik, për arsye të kandidimit tim në organet e rivlerësimit sipas ligjit të sipërpërmendur.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Albana Shtylla